



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION TEKNIK
(MBI GJENDJEN EKZISTUESE)

OBJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I KOPSHTIT ME DREKË, PATOS



ADRESA:

LAGJJA “NAFTËTARI, PATOS

Sistemi konstruktiv i objektit

Objekti i kopshtit eshte nje godine 2-kateshe, e ndertuar ne vitin 1975 ne Lagjien “Naftetari” te qytetit te Patosit. Siperfaqja totale e objektit eshte 1125.4 m² ku secili kat respektivisht ka siperfaqe: kati perdhe 562.7 m² dhe kati i pare 562.7 m².



Sistemi konstruktiv i godines eshte me mure mbajtese kombinuar me kolona b/a ne pjesen e verandes ne ballore dhe ne te dy kahet anesore. Muret mbajtese jane me material tulle te plote. Ne te dy katet, muret perimetral mbajtes te godines jane me trashesi 45 cm ndersa ata te brendshem jane me trashesi 25 cm. Pervec mureve mbajtes ka edhe mure ndares me tulle teke me trashesi 12 cm. Soleta eshte monolite me trashesi 20 cm dhe ngarkesat shkarkojne ne muret mbajtes te vendosur ne drejtim gjatesor. Kolonat b/a te vendosura ne veranden ballore, lindore dhe perendimore kane dimensione 45x45 cm dhe jane te lidhura me trare b/a 45x60 cm. Ne pjesen ballore jane gjithsej 5 kolona ndersa ne pjeset anesore 4 kolona per secilin kah.

Lartesia e katit perdhe te godines eshte 3.0 m ndersa lartesia e katit te pare eshte 3.2 m. Aksesit nga kati perdhe ne katin e pare sigurohet nepermjet shkalleve b/a ku rampa e pare ne ngjitje ka 11 shkalle 30x15cm, sheshpushimi 2.75x1.15m dhe rampa e dyte me 9 shkalle 30x15 cm.

Themelet e godines jane tip themele te vazhduar me gur te vendosur nen muret mbajtes.

Godina ka nje ngritje nga kuota e tokes me xokol me lartesi 1 m.

Hyrja per ne ndertese sigurohet ne 4 pozicione, 2 dyer paralele ne ballor, nje ne lindje, nje ne perendim dhe tjetra ne pjesem e pasme me akses ne depo. Kuota $\pm 0,00$ eshte rreth 90-100 cm nga terreni i sistemuar.

Nga nje vezhgim i pergjithshem, gjendja e konstruksionit mbajtes te godines rezulton te jete e mire, nuk ka plasaritje ne elementet mbajtese, deformime apo cedim te struktures.

Nderhyrjet e projektit

Projekti i rikonstruksionit te godines se kopshtit parashikon nderhyrje me karakter siperfaqesor, pa prekur konstruksionin e godines. Eshte parashikuar prishja e nje muri te brendshem ndares dhe ndertimi i mureve te brendshme ndarese me tulle te lehtesuar, te cilet nuk cenojne elementet mbajtes te godines. Hapesirat e dyerve dhe dritareve do te mbeten te njejta pas rikonstruksionit, pa nderhyre ne arkitraret ekzistues te dyerve dhe dritareve.

Hartoi:

Ing. Silvana Mici